



## **BCSDN bën thirrje për përfshirjen e Kosovës në Nismën e Këshillit Evropian Ekonomik dhe Social për Anëtarët nga vendet Kandidate të Zgjerimit**

Në kuadër të nismës së re dhe të mirëpritur sinqerisht të Këshillit Evropian Ekonomik dhe Social (KEES/EESC) për Anëtarë nga vendet Kandidate të Zgjerimit (AKZ/ECM), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) i bën thirrje KEES-it të rishqyrtojë përjashtimin e Kosovës nga kjo nismë.

KEES është bërë institucioni i parë i BE-së që dëshmon në praktikë se si vendet që kanë një perspektivë të qartë anëtarësimi mund të integrohen gradualisht në BE edhe përpara se të bëhen anëtarë zyrtarë të bllokut. Megjithatë, për shkak se kushti formal për pranueshmëri për këtë nismë i vendosur nga KEES ishte që vendet të jenë kandidatë për anëtarësim në BE, përfaqësuesit e partnerëve socialë nga Kosova janë përjashtuar nga Nisma AKZ e KEES-it. Konsiderojmë se përdorimi i mungesës së statusit të kandidatit si një arsye për përjashtimin nga kjo nismë e pjesëmarrësve nga Kosova nuk është në përputhje me frymën dhe qëllimet e përgjithshme që KEES promovon brenda komunitetit evropian dhe qasjes përfshirëse të KEES para kësaj nisme. Për më tepër, duke qenë se kjo është nisma e parë nga një institucion i BE-së që pilotohet me një qasje pjesëmarrëse përtej Shteteve Anëtare të BE-së, kjo krijon një precedent shqetësues për përjashtimin e Kosovës nga nismat e tjera rajonale të lidhura me BE-në.

BE-ja dhe Shtetet e saj Anëtare kanë shprehur vazhdimisht mbështetjen e tyre të palëkundur për perspektivën evropiane të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Në dokumente të ndryshme zyrtare, si Strategjia e Zgjerimit dhe Raportet vjetore, Kosova nuk përjashtohet nga pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht çështjeve specifike me mosnjohjen nga pesë Shtete Anëtare të BE-së, Kosova është pjesë formale e procesit të integritimit në BE. Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj për zbatim të reformave dhe përafrimin me standardet dhe normat e BE-së, si pjesë e angazhimit të saj aktiv në Procesin e Stabilizim-Asociimit. Kosova gjithashtu ka aplikuar për Statusin e Kandidatit për BE, duke treguar qartë drejtimin strategjik drejt BE-së. Kur bëhet fjalë për demokracinë, përfshirë dialogun social dhe hapësirën qytetare, Kosova ka bërë përparime të rëndësishme gjatë viteve të fundit. Komunikata e KE-së "Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor" thekson se vendet që përparojnë në prioritetet e reformave duhet të presin "hyrje graduale" dhe integrim më të ngushtë me BE-në. Përpjekjet e Kosovës drejt këtij qëllimi nuk duhet të neglizhohen vetëm për shkak se mungon statusi formal i kandidatit.

Së fundmi, përjashtimi i Kosovës nga kjo nismë bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me angazhimet dhe rekomandimet e KEES-it të komunikuar veçanërisht ndaj Kosovës. Në veçanti, raporti i misionit të KEES-it nga seanca e fundit me përfaqësuesit e shoqërisë civile nga Kosova

thekson sfidat me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile në Kosovë për t'iu bashkuar rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare për shkak të statusit të saj, si dhe sugjeron gjetjen e rrugëve për të lehtësuar integrimin e shoqërisë civile të Kosovës në rrjete më të gjera me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit. Për më tepër, rekomandimet nga Opinionet e KEES-it mbi marrëdhëniet BE-Kosovë theksojnë nevojën për të mbështetur krijimin e rrjeteve të shoqërisë civile në Kosovë "me qëllim të lehtësimit të dialogut me autoritetet dhe lidhjen me platformat ekzistuese të shoqërisë civile evropiane".

Ritheksojmë se përjashtimi i Kosovës nga Nisma e KEES-it për Anëtarë nga vendet Kandidate të Zgjerimit është i papranueshëm dhe minon angazhimin e deklaruar të BE-së për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile i bën thirrje KEES-it të korrigjojë këtë lëshim dhe brenda fazës aktuale të pilotimit të zgjerojë kriteret e pranueshmërisë edhe për pjesëmarrësit nga Kosova, duke nxitur kështu bashkëpunim, bashkëveprim dhe përfshirje më të madhe në rrugëtimin e rajonit drejt integritit evropian.